	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA FINANCIE - MINISTRY OF FINANCE KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR KOSOVSKI SAVET ZA FINANSIJSKO IZVESTAVANJE KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL
Nr./Br./No. <u>PP2</u>	Nr.faq./Br.str./No.pg. _____
Date/Datum/Date <u>28.04.2023</u>	PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISHTINA

**Trafiku Urban sh.a**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur  
31 dhjetor 2022**

**PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	8
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	12 – 34



## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhmentit dhe Bordit të Trafiku Urban sh.a

### Raport mbi Pasqyrat Financiare

#### Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të bashkëngjitura të Trafiku Urban sh.a (në vijim referuar si "Kompania") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2022, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshirë në faqet 8-34.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në paragrafin Baza për opinion me rezerve pjese e raportit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2022, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Baza për opinion me rezervë

Siç është shpalosur me tutje në shënimin 5 të pasqyrave financiare përcjellëse, gjendja e Pronës Impianteve dhe Pajimeve të Kompanisë më 31 Dhjetor 2022 është 8,744,022 EUR (31 Dhjetor 2021; 9,831,571 EUR). Të përfshira në Prone impiante dhe pajime janë vlera e Tokës në shumën prej 905,000 EUR dhe vlera e objektit në shumën prej 1,289,660 EUR. Nisur nga natyra e shënimeve që disponon Kompania dhe nga mungesa e procedurave alternative, ne nuk ishim në gjendje të siguronim dëshmi të mjaftueshme për vlerën bartëse të tokës dhe objekteve dhe pronësinë e tyre më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ishin të nevojshme rregullimet e këtyre dy shumave.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për kërkesat specifike në lidhje me auditimin ligjor të subjekteve me interes publik. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë me rezervë.

#### Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

AUDIT & CONTO shpk

Rr. Simon Shiroka 11/4, 10000 Prishtina, Kosovë (tel +38344506702)

Email: [auditonto@gmail.com](mailto:auditonto@gmail.com)

[www.audit-conto.com](http://www.audit-conto.com)

Çështje tjera	Si i adresoj auditimi ynë çështjet tjera
<b>Njohja e te hyrave</b>	
<p>Ne identifikuam njohjen e te hyrave si një çështje kryesore e auditimit për shkak të rëndësisë së te hyrave si balanca me e rëndësishme financiare në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse. Rrjedha kryesore e te ardhurave është nga shitjet e faturuara Komunës së Prishtinës (aksionarit).</p> <p>Detajet për politikat e kontabilitetit janë të shpalosura në Shënimin 3.18 të pasqyrave financiare.</p>	<p>Ne kemi testuar modelimin, zbatimin dhe efektivitetin e kontroleve të brendshme që lidhen me prezantimin, saktësinë dhe tërësinë e te ardhurave. Për më tepër ne kemi kryer procedura thelbësore të auditimit që konsistojnë në testimin e detajeve, procedurave thelbësore analitike dhe metodës së faturimit:</p> <p>Për më tepër ne kemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikuar regjistrimet në librin e përgjithshëm që ndikojnë në balancat e te ardhurave;</li> <li>- Testuar aplikimin dhe përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit për njohjen e te ardhurave;</li> <li>- Bere testimet përmes konfirmimeve;</li> <li>- Gjurmuar informacionin e shpalosjeve të dhënave të kontabilitetit dhe dokumentacionin tjetër mbështetës.</li> </ul>

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare individuale**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare individuale**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

### **Informatat tjera**

Informatat tjera përfshijnë Raportin e menaxhmentit, se bashku me një Deklaratë të qeverisjes Korporative të Organizatës ashtu siç kërkohet nga neni 7 i Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat përbejnë pjesë të veçantë të raportit për vitin financiar që përfundon me 31 Dhjetor 2022.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për informatat tjera**

Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë raportin e menaxhmentit të përfshirë në raportin vjetor.



### **Përgjegjësitë e auditorit**

Mendimi ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe, përveç në masën e deklaruar në mënyrë të shprehur në raportin tonë, ne nuk shprehim ndonjë konkluzion sigurie në të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është që të lexojmë informacionin tjetër, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra në auditim.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit kemi marrë parasysh nëse ai përfshin shpalosjen e kërkuar nga Ligji Nr. 06 / L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin, Neni 10.

Bazuar, vetëm në punën që kërkohet të bëhet gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme sipas mendimit tonë:

### **Opinionit mbi raportin e Menaxhmentit**

Bazuar ne punën tonë të kryer gjatë auditimit, opinionit jone është se raporti i Menaxhmentit:

- është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, neni 10 dhe
- është në përputhje me informacionin e përfshirë në pasqyrat financiare.

Për me tepër, ne njohuritë e te kuptuarit tone të Organizatës dhe mjedisit të saj të marrë gjatë auditimit, ne nuk kemi identifikuar ndonjë keqpohim material të Raportit të Menaxhmentit.

### **Opinion mbi Deklaratën e Qeverisjes Korporative**

Në opinionin tonë, Deklarata e Qeverisjes Korporative të Organizatës përmban të gjitha informacionet siç kërkohet nga neni 7 i ligjit dhe është në përputhje me informacionin e përfshirë në pasqyrat financiare.

### **Raport mbi kërkesat tjera ligjore dhe rregullative**


#### **Deklaratë në lidhje me ofrimin e shërbimeve jo të auditimit**

Në më të mirën e njohurive dhe besimit tonë, ne sigurojmë që nuk kemi ofruar asnjë shërbim jo-auditues të cilat janë të ndaluara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2021 për Pavarësinë e Auditorëve Ligjorë dhe Firmave të Auditimit.

### **Emërimi i auditorit**

Ne u emëruam si Auditor të Pasqyrave financiare të Organizatës me 8 Prill 2022 përmes një procesi të tenderimit publik. Ne konfirmojmë se nga këndvështrimi i Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, ky është viti i parë që ne po ofrojmë shërbime të auditimi për pasqyrat financiare të Kompanisë.

Audit & Conto,

  
Ymer Shatri  
Partner Angazhimi  
24 Prill 2023



AUDIT & CONT shpk

Rr. Simon Shiroka 11/4, 10000 Prishtina, Kosovë (tel +38344506702)

Email: [auditconto@gmail.com](mailto:auditconto@gmail.com)

[www.audit-conto.com](http://www.audit-conto.com)

**TRAFIKU URBAN SH.A**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar 31 Dhjetor 2022**

		Më 31 Dhjetor, 2022	Më 31 Dhjetor 2021
		(në '000 Euro)	(në '000 Euro)
<b>ASSETS</b>	Shënimi		
<b>Asetet jo qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	5	8,744,022	9,831,571
Asetet e paprekshme			
		<b>8,744,022</b>	<b>9,831,571</b>
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Stoqet	6	939,203	826,322
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	122,533	422,044
Parapagimet dhe kërkesat tjera	8	43,851	54,419
Paraja në dorë dhe në banka	9	762,728	973,996
		<b>1,868,315</b>	<b>2,276,781</b>
<b>GJITHSEJT ASETET</b>		<b>10,612,337</b>	<b>12,108,352</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali themelues dhe rezervat	10	2,024,193	2,024,193
Fitimet e bartura		2,101,989	2,195,569
		<b>4,126,182</b>	<b>4,219,762</b>
<b>Detyrimet jo-rrjedhëse</b>			
Huaja – obligimi afatgjatë	11	4,592,870	5,613,508
Detyrimi I tatimit te shtyre		417,907	557,725
		<b>5,010,777</b>	<b>6,171,233</b>
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>			
Llogarit e pagueshme dhe të tjera	12	339,836	509,493
Huaja – obligimi afatshkurtër	11	1,020,638	1,020,638
Detyrimet tjera afatshkurtra	13	114,903	187,226
		<b>1,475,377</b>	<b>1,717,358</b>
<b>TOTAL DETYRIMET</b>		<b>6,806,771</b>	<b>7,888,590</b>
<b>TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET</b>		<b>10,612,337</b>	<b>12,108,352</b>

Autorizuar për publikim nga ana e menaxhmentit dhe nënshkruar në emër të tyre më 29 Mars, 2023

Z. Burim Maraj

Kryeshetëf Ekzekutiv



Znj. Shukrije Morina

U.D. ZKFTH

Shënimet e bashkangjitura prej 12 deri 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

**TRAFIKU URBAN SH.A**
**Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse 31 Dhjetor 2022**

	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
Shitjet	14	7,488,513	7,233,836
Të hyrat nga grantet	15		
Të hyrat tjera	16	138,060	51,728
		<b>7,626,573</b>	<b>7,285,563</b>
<b>SHPENZIMET OPERATIVE</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5	(1,101,416)	(1,099,636)
Shpenzimet e personelit	15	(3,270,120)	(2,949,732)
Shpenzimet e derivateve		(2,606,854)	(1,582,984)
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe auto pjesëve		(317,806)	(300,190)
Shpenzimet e tjera operative	16	(488,528)	(294,616)
		<b>(7,784,724)</b>	<b>(6,227,158)</b>
<b>Fitimi nga operacionet</b>		<b>(158,151)</b>	<b>1,058,405</b>
Të hyrat financiare (Shpenzimet), neto	17	(75,246)	(85,824)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>(233,398)</b>	<b>972,581</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	18	139,818	(180,798)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>(93,580)</b>	<b>791,784</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>			
<b>Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim dhe humbje</b>			
Efkti i tatimit to shtyer ne rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	20	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(93,580)</b>	<b>791,784</b>



**TRAFIKU URBAN SH.A**

Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet 31 Dhjetor 2022

	Kapitali aksionar	Rezervat	Humbjet e akumuluar	Gjithsej
<b>Gjendja më 01 Janar 2022</b>	<b>25,000</b>	<b>1,999,193</b>	<b>2,195,569</b>	<b>4,219,762</b>
Transaksionet me pronarët				
<b>Transaksionet me pronarët</b>				
Fitimi i vitit			(414,196)	(414,196)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse				
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			(414,196)	(414,196)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>25,000</b>	<b>1,999,193</b>	<b>1,781,373</b>	<b>3,805,566</b>
<b>Gjendja më 01 janar 2021</b>	<b>25,000</b>	<b>1,999,193</b>	<b>1,403,785</b>	<b>3,427,978</b>
Transaksionet me pronarët				
<b>Transaksionet me pronarët</b>				
Fitimi i vitit			791,784	791,784
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse				
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			791,784	791,784
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>25,000</b>	<b>1,999,193</b>	<b>2,195,569</b>	<b>4,219,762</b>

Shënimet e bashkangjitura prej 12 deri 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

**TRAFIKU URBAN SH.A****Pasqyra e rrjedhës së parasë për fund vitin 31 Dhjetor 2022**

**Viti qe përfundon me 31 Dhjetor,**  
**2022                                  2021**

**Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative**

Fitimi / (humbja) i / e vitit	(414,196)	972,581
<b>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</b>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	1,101,416	1,099,636
Te hyrat e liruara ng ate hyrat e shtyra		
Shpenzimet e tatimit në fitim	180,798	
	<b>868,018</b>	<b>2,072,217</b>
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	299,511	135,475
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(112,881)	(72,312)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	10,568	12,385
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(169,657)	(16,381)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	(72,323)	(623,793)
	<b>(44,782)</b>	<b>(564,626)</b>
Tatimi në fitim i paguar		
Interesi i paguar		
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>823,236</b>	<b>1,507,592</b>

**Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese**

Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(13,866)	(28,689)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(13,866)</b>	<b>(28,689)</b>

**Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese**

Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		
Ripagimi i kredive dhe huave	(1,020,638)	(1,020,638)
Pagesat e lizingut financiar		
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>(1,020,638)</b>	<b>(1,020,638)</b>

**Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	(211,267)	458,265
	973,996	515,731
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>762,728</b>	<b>973,996</b>

Shënimet e bashkangjitura prej 12 deri 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## TRAFIKU URBAN SH.A

### Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2022

---

#### 1. TË PËRGJITHSHME

N.P.K. "Trafiku Urban" është shoqëri aksionare e themeluar më 01.04.1976, në mënyrë të organizuar nga Komuna e Prishtinës, si Ndërmarrje Publike Komunale (N.P.K.).

Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-111 të datës 20.04.2012 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Komunale me nr. 03/L-087 "Trafiku Urban" është regjistruar si Ndërmarrje Publike Komunale SHA në Prishtinë.

Komuna e Prishtinës zotëron 100% Aksionet e Ndërmarrjes.

Numri Fiskal: 600215611

Numri i Certifikatës TVSH: 330076598

Adresa: Rruga Tahir Zajmi, nr. 43, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Kompania gjatë me 31 Dhjetore 2022 ka pasur 414 punëtorë.

**2. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara të Raportimit Financiar Ndërkombëtarë**

Kompania ka zbatuar të gjithë Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('IASB') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Çdo standard ose interpretim i kontabilitetit i ri ose i ndryshuar që nuk është ende i detyrueshëm nuk është miratuar më herët. Zbatimi i këtyre standardeve dhe interpretimeve nuk kishte ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- Ndryshimet në SNRF 3 Referenca te Korniza Konceptuale
- Ndryshimet në SNK 16 Prona, Impiantet dhe pajisje - Të ardhurat para përdorimit te përcaktuar
- Ndryshimet në SNK 37 Kontratat e komplikua - Kostoja e pëmbushjes se një Kontrate

**2.1 Përmirësimet Vjetore ndaj SNRF-ve; Standardet e Kontabilitetit Cikli 2018-2020**

- SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- SNRF 9 Instrumentet Financiare
- SNRF 16 Qiratë
- SNK 41 Bujqësi

**2.2 Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të miratuara**

Standarde dhe interpretime të reja janë publikuar që nuk janë obligative për periudhën raportuese me 31 dhjetor 2022 dhe të cilat nuk janë miratuar më herët nga Kompania.

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por nuk janë ende në fuqi, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Kompanisë janë shpalosur më poshtë:

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2023),
- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët
- Ndryshime në SNK 1 Klasifikimi i pasiveve si afatshkurtër ose afatgjatë
- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF Deklarata praktike 2; Shpalosja e politikave të kontabilitetit
- Ndryshime në SNK 8 Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël
- Tatimi i shtyrë lidhur me Pasuritë dhe Detyrimet nga një Transaksion i Vetëm

Standardet e reja, rishikimet dhe interpretimet nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

### 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

#### 3.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

#### 3.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike përveç rastit të rivlerësimit të disa asetëve dhe detyrimeve financiare, siç është shpjeguar më poshtë në politikat e kontabilitetit. Kostoja historike është e bazuar në përgjithësi në shumën e dhëne në këmbim të pasurisë.

#### 3.3 Parimi i vazhdueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë.

#### 3.4 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euroja (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euroja ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

#### 3.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të asetëve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diference ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit

#### 3.6 Prona, impiantet dhe pajisjet

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të asetëve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që mundë të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin të cilat do rrjedhin për Kompaninë dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet ngarkohen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

**Zhvlerësimi:** Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar:

	Jetë të dobishme në vite	Zhvlerësimi në %
Ndërtesat	20 vite	5%
Autobusët	12 vite	8.33%
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite	20%
Automjete	5 vite	20%
Pasuri tjera të trupëzuara	5 vite	20%

**3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

**3.7 Asetet e paprekshme**

Asetet e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Asetet e paprekshme me jetë të dobishme të papërcaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

**3.8 Mosnjohja e aseteve të paprekshme**

Një aset i paprekshëm nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aseti të paprekshëm, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të asetit, njihen në fitim ose humbje kur aset i është çregjistruar.

**3.9 Dëmtimi i aseteve jo-financiare**

Asetet që kanë kohë të pakufizuar të përdorimit nuk i nënshtrohen përdorimit dhe testohen në baza vjetore për dëmtim. Asetet të cilat i nënshtrohen amortizimit rishikohen për dëmtim kurdoherë kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera e bartur mund të mos jetë e rikuperueshme. Humbja nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera e bartur e asetit e tejkalon shumën e rikuperueshme të atij aseti. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës reale të asetit minus kostoja e shitjes dhe vlera në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, asetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrjedha të identifikueshme të veçanta të parave (njësi që gjenerojnë para). Asetet jo-financiare që kanë pësuar dëmtime rishikohen për rikthime të mundshme të dëmtimit në secilën datë raportuese.

**3.10 INSTRUMENTET FINANCIARE*****Njohja dhe çregjistrimi***

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur ai shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

***Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare***

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korrigjuar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme).

### 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto të amortizuara.
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë aktiv financiar të kategorizuar si FVOCI dhe (FVTPL).

Klasifikimi përcaktohet nga të dyja:

- Modeli i biznesit së njësisë ekonomike në menaxhimin e pasurisë financiare.
- Karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare të cilat njihen në fitim ose humbje janë përfshirë brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare, të cilat paraqiten brenda shpenzimeve të tjera..

#### *Matja e mëpasshme e pasurive financiare*

##### **Pasuritë financiare me kosto të amortizuar**

Pasuritë financiare maten me kosto të amortizuar atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të paracaktuara si FVTPL):

- ato janë të mbajtura brenda një modeli biznesor, qëllimi i së cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe grumbullimi i flukseve monetare kontraktuale.
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare prodhojnë flukse të mjeteve monetare, pagesa e kryegjësë dhe interesit, të shumës kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto pasuri maten me kosto të amortizuar përmes metodës efektive të interesit. Zbritja nuk aplikohet atëherë kur efekti i zbritjes është jo material. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera përfshihen tek instrumentet financiare.

##### **Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes (FVTPL)**

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të grumbulluar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë aktiv financiar të kategorizuar si (FVTPL).

##### ***Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)***

Kompania llogarit Pasuritë financiare në FVOCI nëse asetet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektivi i të cilit është "të mbajë mbledhjen" e flukseve monetare të lidhura dhe të shesë dhe

**3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (OCI) do të riciklohet pas mosnjohjes së aktivitetit.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë aktiv financiar të kategorizuar si (FVOCI).

**Zhvlerësimi i pasurive financiare**

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kreditit - 'modelin e pritur të humbjes kreditore (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe Pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, Pasuritë e kontratës të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes..

Njohja e humbjeve të kreditore nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditore. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritura kreditore, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit..

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte Pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit. '12 - mujore humbjet e pritshme të kredisë 'njihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme të kreditit të jetës 'njihen për kategorinë e dytë. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

**Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera**

Kompania përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe regjistron kompensimin për humbjet si humbjet e pritshme të kreditit të jetës. Këto janë mangësitë e pritura në flukset e mjeteve monetare kontraktuale, duke pasur parasysh potencialin e mosplotësimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Gjatë llogaritjes, kompania përdor përvojën e saj historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritshme të kredisë duke përdorur një matricë provizionit.

Kompania vlerëson zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare duke u bazuar në vlerësimin e menaxhmentit të humbjeve të pritshme të kredisë, duke marrë parasysh faktorë specifikë siç janë vjetërsia e bilancit, ekzistenca e mosmarrëveshjeve, modelet e pagesave historike të fundit dhe çdo informacion tjetër i disponueshëm në lidhje me besueshmërinë e palëve. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera janë të grupuara në bazë të të arkëtimit të kaluara dhe jo të kaluara. Referojuni tek shënimi i Të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe Riskut Kreditor për një analizë më të detajuar se si zhvlerësimi është llogaritur.

**Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare**

Duke qenë se kontabilizimi i pasiveve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Kompanisë nuk kanë ndikuar nga miratimi i SNRF 9. Megjithatë, për plotësinë, politika kontabël është dhënë më poshtë.



**3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë detyrimet tregtare dhe të tjera të pagueshme në datat e raportimit.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania ka përcaktuar një pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

**3.11 Matja e vlerës së drejtë**

Kur një pasuri apo detyrim, financiar apo jo-financiar, matet me vlerën e drejtë për njohje ose dhënie informacionesh, vlera e drejtë bazohet në çmimin që do të merrej për të shitur një pasuri ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësit e tregut në datën e matjes; dhe supozon se transaksioni do të bëhet ose: në tregun kryesor; ose në mungesë të një tregu kryesor, në një treg më të favorshëm.

Vlera e drejtë matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin kur çmimi i aktivitetit ose detyrimit, supozohet se veprojnë në interesat e tyre më të mirë ekonomik. Për pasuritë jo-financiare, matja e vlerës së drejtë bazohet në përdorimin e saj më të lartë dhe më të mirë. Teknikat e vlerësimit se janë të përshtatshme për rrethanat dhe për të cilat të dhënat të mjaftueshme janë në dispozicion për të matur vlerën e drejtë, janë përdorur, duke maksimizuar përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizuar përdorimin e inputeve të paverifikueshme

Pasuritë dhe detyrimet e matura me vlerën e drejtë klasifikohen në tre nivele, duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve. Klasifikimet rishikohen në çdo datë raportimi dhe transferimet ndërmjet niveleve përcaktohen bazuar në rivlerësimin e nivelit më të ulët të inputit që është i rëndësishëm për matjen e vlerës së drejtë.

Për matjet e përsëritura dhe jo të përsëritura të vlerës së drejtë, vlerësuesit e jashtëm mund të përdoren kur ekspertiza e brendshme ose nuk është e disponueshme ose kur vlerësimi vlerësohet të jetë i rëndësishëm. Vlerësuesit e jashtëm zgjidhen bazuar në njohuritë dhe reputacionin e tregut. Kur ka një ndryshim të rëndësishëm në vlerën e drejtë të një pasurie ose detyrimi nga një periudhë në tjetrën, është ndërmarrë një analizë, e cila përfshin një verifikim të inputeve kryesore të përdorura në vlerësimin e fundit dhe një krahasim, kur është e aplikueshme, me burimet e jashtme të të dhënave

**3.12 Klasifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë**

Pasuritë dhe detyrimet janë të paraqitura në pasqyrën e pozitës financiare duke u bazuar në klasifikimin afatshkurtër dhe afatgjatë.

Një pasuri klasifikohet si afatshkurter kur: ose pritet të realizohet prej saj ose qëllimi është për t'u shitur ose për t'u konsumuar në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose pasuria është kesh apo ekuivalent i keshit përveç nëse ndalohet për t'u këmbyer apo për t'u përdorur për kryerjen e një detyrimi për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha pasuritë tjera klasifikohen si afatgjatë.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur: ose pritet të kryhet në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të kryhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose nuk ka të

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

drejtë të pakushtëzuar për t'a shtyer kryerjen e detyrimit për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet tjera klasifikohen si afatgjata.

Tatimi i shtyrë si pasuri dhe detyrime gjithnjë klasifikohet si afatgjatë.

#### **3.13 Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshinë paranë e gatshme, depozitat në të pare dhe investimet e tjera shumë likuide afatshkurtera të cilat janë lehtë të konvertueshme në një shumë të njohur të parave dhe janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë.

#### **3.14 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera**

Të arkëtueshmet tregtare janë fillimisht të njohura me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë lejim për humbjet e pritura të kreditit. Të arkëtueshmet tregtare në përgjithësi janë për t'u kryer brenda 30 deri 60 ditë.

Kompania ka aplikuar një qasje të thjeshtuar për matjen e humbjeve të pritura të kreditit, që përdor një lejim për humbjet e pritura gjatë jetëgjatësisë. Për të matur humbjet e pritura të kreditit, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të ditëve të vonesës.

Të arkëtueshmet tjera janë njohur sipas koston së amortizimit, minus ndonjë lejim për humbjet e pritura të kreditit.

#### **3.15 Inventari**

Materialet, pjesët rezervë dhe të konsumit, kryesisht lidhen me operacionet e përditshme të kompanisë, dhe janë vlerësuar me koston më të ulët të dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e bëra në blerjen e stoqeve dhe sjelljen e tyre në vendin e tyre dhe kushtet aktuale. Vlera e realizueshme neto është cmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes. Materialet dhe pjesët rezerve shpenzohen apo kapitalizohen në asetin material të përshtatshëm kur instalohen. Një provizion për stoqet me levizje të ngadalshme dhe të vjetërsuara njihet në fitim ose humbje, bazuar në vlerësimin me të mirë të menaxhmentit

#### **3.16 Huazimet**

Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitjeje, i shtohen kostot e atyre asetëve, deri në kohën kur aktivet janë në thelb të gatshme për përdorimin ose shitjen e synuar të tyre.

